

**LIGJI Nr. 04/L-089
PËR DEMINIM HUMANITAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR DEMINIM HUMANITAR

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj përcakton aktivitetin e deminimit humanitar, institucionet kompetente, kushtet dhe kriteret për akreditimin e organizatave që merren me deminim humanitar.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Ky ligj rregullon veprimtaritë që kanë të bëjnë me deminim humanitar në Republikën e Kosovës.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **FSK** - Forca e Sigurisë së Kosovës;

1.2. **MFSK** - Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës;

1.3. **QKD** - Qendra Koordinuese për Deminim në kuadër të MFSK;

1.4. **EMSH** - Eliminimi i mjeteve shpërthyes;

1.5. **MEP**- Mjetet e pashpërthyer;

1.6. **ME**– Mjetet eksplozive - Të gjitha municionet që përmbajnë eksplozivë, materiale të fizionit apo fuzionit nuklear dhe agjentët biologjikë dhe kimikë. Kjo përfshinë bombat dhe kokat e raketave, raketat e drejtuara dhe ato balistike, artilerinë, mortajat, raketat dhe municionet e armëve të vogla, të gjitha minat, torpedot dhe bombat e thellësisë, piroteknika, kasetat dhe shpërndarësit, mjetet që aktivizohen me fishekë dhe shtytës, mjetet elektro-eksplozivë, mjetet shpërthyes klandestine dhe të improvizuara, si dhe të gjitha mjetet apo komponentët e ngjashëm apo të përfaqësuar që kanë natyrë eksplozive;

1.7. **SNAM** – Standardet ndërkombëtare për aksionin ndaj minave;

1.8. **Akreditim** – Procedura sipas së cilës një organizatë deminuese është njohur në mënyrë formale si kompetente dhe e aftë të planifikojë, menaxhojë dhe kryejë operacionet e deminimit në mënyrë të sigurt dhe efikase;

1.9. **Sigurimi i Cilësisë (SC)** - mbulon tërë procesin për t'u siguruar që zonat janë pastruar sipas SNAM-it;

1.10. **Deminim Humanitar**- nënkupton aktivitetet për heqjen e minave dhe mjeteve tjera eksplozive, përfshirë vëzhgimin teknik, hartat, shënjimin, pastrimin, dokumentimin pas pastrimit, komunitetin ndërlidhës të aksionit të minave dhe pranim-dorëzimit të fushës së pastruar. Deminimi mund të kryhet nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe njësitë ushtarake të deminimit.

Neni 4 Aktivitetet e deminimit humanitar

1. Aktivitetet e deminimit humanitar janë:

1.1. pastrimi i fushave të minuara dhe eliminimi i MEP;

1.2. eliminimi i ME; dhe

1.3. përdorimi i eksplozivëve për operacionet e deminimit humanitar dhe të EMSH-së. Kjo do të rregullohet me rregullore të veçantë të nxjerrë nga MFSK-ja.

Neni 5 Institucionet kompetente

Deminimin humanitar në Republikën e Kosovës do ta bëjë Njësia e Deminimit e FSK-së, dhe organizatat e akredituara nga QKD-ja.

Neni 6 Veprimtaria dhe kompetencat e QKD-së

1. QKD-ja është autoriteti koordinues dhe pikë kontakti për të gjitha aktivitetet e deminimit humanitar në Republikën e Kosovës.

2. Kompetencat e QKD-së janë si në vijim:

2.1. të koordinojë përdorimin e eksplozivëve dhe pjesëve përcjellëse të eksplozivëve për aktivitetet e deminimit humanitar;

2.2. të sigurojë mbikëqyrjen adekuate dhe menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të deminimit humanitar;

2.3. të zhvillojë planet dhe prioritetet për aktivitetet e deminimit humanitar;

2.4. të ruajë kapacitetet e SC-së dhe të bëjë kontrollë të SC-së, që të sigurojë se deminimi dhe eliminimi i MEP-ve të bëhet në mënyrë të sigurt dhe sipas standardeve të SNAM-it;

2.5. të koordinojë aktivitetet për edukimin dhe informimin e publikut lidhur me rreziqet nga minat dhe mbetjet e tyre;

2.6. të administrojë bazën e të dhënave të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Deminim;

2.7. të vërtetojë që zona shpallur pa mina është pastruar sipas SNAM-it -it;

2.8. të hartojë planin afatshkurtër dhe afatmesëm;

2.9. të akreditojë, suspendoj, anuloj dhe të vazhdojë akreditimin e organizatave për deminim humanitar.

Neni 7 Koordinimi në mes të institucioneve

1. Nëse institucionet vendore dhe ndërkombëtare marrin informacion apo veprim lidhur me ndonjë mjet eksploziv, duhet ta informojnë QKD-në.
2. Koordinimi në mes të institucioneve për shkëmbim të informacioneve dhe koordinimi për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara rregullohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.
3. Organizatat e akredituara nga QKD-ja duhet të raportojnë për aktivitetet e tyre në pajtim me SNAM - in.
4. QKD-ja siguron që t'i vërë në dispozicion informacionet lidhur me zonat e rrezikshme nga minat dhe MEP-të.

Neni 8 Plani afatmesëm dhe afatshkurtër

1. Plani afatmesëm është dokument strategjik për zhvillimin e aktiviteteve të deminimit humanitar në Republikën e Kosovës për një periudhë tre (3) vjeçare.
2. Plani afatshkurtër do të përgatitet në bazë të planit afatmesëm strategjik, sipas nevojave, burimeve, kapaciteteve dhe prioriteteve që ka QKD-ja, përfshirë edhe propozimet e donatorëve.
3. Plani afatmesëm dhe Plani afatshkurtër hartohet nga QKD-ja dhe miratohet nga Ministri i FSK-së.

Neni 9 Kushtet dhe kriteret për akreditim

1. Aktivitetet e deminimit humanitar në Republikën e Kosovës kryhen nga organizatat e akredituara nga QKD-ja.
2. Procesi i akreditimit që përfshinë kriteret për akreditim, suspendimin dhe anulimin e akreditimit rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 10 Dispozitat kalimtare

MFSK-ja do t'i nxjerrë aktet nënligjore në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 11 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-089
15 mars 2012**

Shpallur me dekretin Nr.DL-011-2012, datë 02.04.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.